

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Përgjimet\ Epshi i Vlorës dorëzoi në duart e Gysit sigurinë e shtetit
ADRESA	https://joq-albania.com/artikull/1393650.html
BURIMI	joq-albania.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 19:02:41 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	23 shtator 2026, 14:37:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto den text_date. Dritarja: 23 shtator 2026, 14:36:00 UTC → 23 shtator 2026, 14:38:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f6585c7b7322407201553c3cb2d222f20fdbeb56154640115e76a9305e1220e3
TEKSTI	7fe70c94bb2d4ea83ecc5f3e8cf7330ffae8306b7d0ffdc293fa4155371767
PAMJA	d64537d712f9025cac6f82f921a6a2ac12fcb4a1d5f387f20e6db258552afb90

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	51d39c29dcc3bf3e42b7143ac3266b334527f1c35ba69ada9c1bf5f65990d6f5
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/51d39c29dcc3bf3e42b7143ac3266b334527f1c35ba69ada9c1bf5f65990d6f5>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Përgjimet\ Epshi i Vlorës dorëzoi në duart e Gysit sigurinë e shtetit

Shkruar nga: I Cani | Publikuar më: 23.09.2026, 16:37

 Share

 Share



Komunikime private, takime me drejtuesit më të lartë të shtetit dhe informacione që, sipas SPAK, i përcilleshin një personi nën hetim. Dosja hetimore ngre pikëpyetje serioze mbi mënyrën se si është menaxhuar informacioni nga drejtuesja e Shërbimit Informativ të Shtetit, Vlora Hyseni.

Sipas materialeve të siguruara nga dosja hetimore, Hyseni ka pranuar se ka komunikuar në mënyrë të vazhdueshme me Ergys Agasin deri në ditën e arrestimit të tij. Ajo ka deklaruar se Agasi i kishte ofruar "bashkëpunim", ndërsa ka mohuar që të ketë dhënë informacione nga SHISH.

Por SPAK, në analizën e komunikimeve të sekuestruara, jep një tjetër këndvështrim dhe pretendon se Agasi nuk shfaqet thjesht në rolin e një "bashkëpunëtori", por si person që merre dhe orientonte informacionin.

Dhe pikërisht këtu nis pjesa më e debatueshme e dosjes.

"Zemër", "shpirt" dhe qindra komunikime

Mesazhet e publikuara në dosje tregojnë një komunikim të shpeshtë mes Hysenit dhe Agasit.

Në një prej tyre, **Vlora Hyseni i shkruan Ergys Agasit:**

"Krejt këta njerëz që na kanë bërë çka na kanë bërë dua që të paguajnë."

Në një tjetër:


"Zemër, thjesht duhet të koncentrohemi te halli ynë."

Ndërsa në komunikime të tjera shfaqen:

"Të gjithë ne"

dhe

"Do përfundojmë keq, shpirt."



Më të Lexuarat



ARTIKULL JOETIK?

Sipas SPAK, komunikimet nuk kufizohen vetëm të biseda personale.

Takimi me kryeministrin, direkt në telefon

Më 24 gusht 2026, sipas dosjes, **Vlora Hyseni i shkruan Ergys Agasit:**

“Nesër duhet ta takoj KM në 8:30”.

SPAK thotë se Hyseni i përcillte Agasit edhe informacione mbi takimet, itineraret dhe aktivitetin e saj zyrtar.

Në një tjetër komunikim, Hyseni i shkruan:

“Skënderi më thirri me u taku të hënën”.

Më pas:

“Të shpresojmë që ka porosit KM...”

Në dosje, “Skënderi” identifikohet si **Skënder Hita**, Drejtor i Përgjithshëm i Policisë.

Balla dhe Balluku në komunikime

Një tjetër pjesë e dosjes lidhet me informacionet për zyrtarë të tjerë të lartë.

Vlora Hyseni i shkruan Ergys Agasit:

“Taulant Balla kryetar Kuvendi.... Kështu janë infot... Bela me Taon shoku”.

Sipas dosjes, referencat lidhen me **Taulant Ballën** dhe **Belinda Ballukun**.

508 komunikime dhe një pyetje që rëndon mbi dosjen

Sipas SPAK, vetëm nga pajisja e Ergys Agasit janë administruar **508 forma komunikimi** me Vlora Hysenin, duke përfshirë telefonata, video-thirrje dhe mesazhe.

Për më tepër, komunikimet kanë vijuar edhe gjatë periudhës kur Agasi ishte shpallur në kërkim.

Për një institucion si SHISH, ku informacioni është vetë thelbi i funksionimit, këto të dhëna kanë një peshë të veçantë. Dosja ngre pikëpyetjen se **deri ku ka shkuar informacioni që një drejtues i shërbimit sekret mund t'i ketë përcjellë një personi nën hetim** dhe nëse janë respektuar rregullat e sigurisë së informacionit.

Nuk është thjesht çështja e një komunikimi “mes dy njerëzve”. Është pyetja se çfarë informacioni ka dalë nga rrethi i një institucioni që ka për detyrë të mbrojë informacionin e ndjeshëm të shtetit.

SPAK e ka ngritur këtë si pjesë të hetimit. Përgjegjësia përfundimtare, nëse ka, do të përcaktohet nga organet gjyqësore.

FACT CHECK: Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e [raportoni këtu](#).

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

TË NGJASHME

Më të fundit



Dërgo materialin tënd këtu >

Puno me ne!

Marketing

Politika e privatësisë

Rreth Nesh

Kushtet e përdorimit

Kontakt

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.